

Bashkia Shkodër trajton problematikën e qenve endacakë në territorin e saj.

Me ane të programit për trajtimin e kafsheve të rrugës, Bashkia Shkodër ka bërë të mundur trajtimin e qenve endacakë duke përdorur metodën K.S.V.L. (Kap, Sterilizo, Vaksino. Lësho) si një nga metodat më të përshtatshme për trajtimin e qenve të rrugës. Po ashtu janë kryer matrikullimi, dehelmetizimi si dhe trajtime të ndryshme antiparazitare këtyre kafshëve.

1. Bazuar në ligjin Nr 71/2020 Për disa ndryshime në ligjin 10465, datë 29.09.2011, “Për Sherbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nëni 54 nuk ka sherbim veterinar pranë njësive të qeverisjes së pushtetit vendor.
2. Fondi i percaktuar në buxhet për trajtimin veterinar të qenve të rrugës sipas viteve është si më poshtë:
3. 

<u>Viti</u>	<u>Buxheti i percaktuar ( në mijë leke)</u>
2019	1,000
2020	1,020
2021	1,924
2022	6,326 ( 1,326 trajtimi veterinar i qenve të rrugës, 5,000 ndertimi i strehezes Faza e I )
2023	10,500 ( 1,500 trajtimi veterinar i qenve të rrugës ; 4,500 funksionimi i strehezes së qenve ; 4,500 Ndertimi i strehezes së qenve Faza e II)
4. Meqenëse Njësitet e Qeverisjes Vendore, bazuar në ligjin Nr 71/2020 Për disa ndryshime në ligjin 10465, datë 29.09.2011, “Për Sherbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nuk kanë sherbim veterinar nuk ka një program të profilaksisë veterinare.
5. Nga ana e Bashkisë Shkodër janë identifikuar pjesërisht dhe po vazhdon puna për identifikimin e plote në të gjithë territorin, por duhet të theksojmë gjithashtu se formati sipas VKM Nr 475/2021 nuk është miratuar akoma.
6. Sterilizimi dhe vaksinimi i qenve të rrugës kryhet nepermjet procedurës së prokurimit nga klinika veterinare të specializuara.
7. Grumbullimi i qenve të rrugës kryhet me ndihmën e organizatave të mbrojtjes së kafsheve dhe punonjësve të Bashkisë Shkodër të cilët dërgohen në strehezen për kafshet endacake.
- 8.
9. Nuk kemi pasur raste të eliminimit të qenve dhe maceve të rrugës.
10. Nuk kemi pasur konstatime të rasteve të braktisjes së kafsheve të shoqerimit nga pronaret e tyre.
11. Për rastet që në ambientet publike kafshet e shoqerimit mund të përbejnë rrezik për njerëzit apo kafshet e tjera, Bashkia Shkodër ka detyrim vendosjen e sinjalistikës e cila akoma nuk është percaktuar nga AKVBM ( VKM 475/2021)
12. Për sa i përket detyrimit që pronaret e kafsheve të shoqerimit të vendosin maska mbrojtëse qenve që i perkasin racave agresive gjatë qëndrimit në ambiente publike nuk janë marrë masa.

13. Ne disa raste jane konstatuar raste te helmimit te qenve te rruges por nuk jane arritur te identifikohen shkaktaret.
14. Rastet e helmimit apo te keqtrajtimit jane konstatuar nga Shoqatat e Mbrojtjes se Kafsheve ne territort dhe i jane referuar organeve ligjzbatuese.
15. Bashkia Shkoder ka informacion per sjelljen nga territore te tjera jashte Bashkise te qenve por qe nuk eshte arritur te identifikohen dhe faktohet.
16. Nga ana e qytetareve, keto 5 vitet e fundit , kemi pasur 6 ankesa per situaten e qenve te rruges.
17. Numri i kafsheve te matrikulluara, sterilizuara dhe vasksinuara ne keto vitet e fundit eshte:

<u>Viti</u>	<u>Nr. Qen te trajtuar</u>
2018	170
2019	225
2020	214
2021	260
2022	172
2023	164 ( ne process)

18. Qe nga viti 2022 eshte ngritur dhe funksionon Streheza per qente e rruges. Eshte ne perfundim faza e dyte e ndertimit te kesaj streheze.
19. Steheza per qente e rruges ofron strehim te perhershem per keto kafshe dhe administrohet nga vete Bashkia Shkoder. Çdo i interesuar mund te vizitoje kete strehez si dhe ka dhe mundesine e adoptimit . Deri tani nuk jane paraqitur kerkesa per adoptim.